



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2021

VENDIM
Nr. 246, datë 09.06.2021

PËR
SKUALIFIKIMIN E KANDIDATES ZNJ. {...}
DHE PËRJASHTIMIN E SAJ NGA PROCEDURAT E EMËRIMIT
NË GJYKATËN E LARTË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 136 dhe në nenin 147/a, pika 1, shkronjat “c” dhe “ë”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 61, pika 2, shkronja “c”, në nenin 86, shkronjat “ç” dhe “ë”, në nenin 97, pika 1, shkronja “a” dhe pika 3, në nenin 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 48, pika 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 113 dhe 114, të Kodit të Procedurave Administrative, në nenin 58, pika 1, shkronja “c”, në nenet 61 dhe 62, të Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Kreun VI, Seksioni Ç, pika 12, shkronja “dh”, si dhe në Kreun XI, Seksioni B, pika 7, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatorja znj. Marçela Shehu,

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 330, datë 17.09.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për verifikimin e plotësimin nga kandidatja znj. {...}, të tre kriterëve të kandidimit për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 87 datë 26.02.2020 dhe vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit”.
2. Skualifikimin e kandidatës znj. {...} dhe përjashtimin e saj nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 87, datë 26.02.2020 .
3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatës znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.
4. Kundër vendimit mund të paraqitet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR